

## **KURSI I GJUHES SHQIPE EDHE NE QYTETIN SAKARYA – ADAPAZAR TE TURQISE**

U.D. Drejtori i Qendres Kulturore te Kosoves z. Qamil BYTYÇI i shoqeruar nga Z. Ömer KURTES, Z. Shaban KOLUDRA si dhe Burhanettin ÇALIŞKAN - shqiptare me banim ne Sakarya – Adapazar te Turqise me daten 04.06.2014 paten nje takim me Drejtorin Drejtorise se Kultures dhe Puneve Shoqerore te Bashkise Sakarya - Adapazar Z. İbrahim AKTÜRK me te cilin u bisedua per hapjen e kursit te Gjuhes Shqipe ne muajin Shtator ne Sakarya - Adapazar.

Ne takim z. İbrahim AKTÜRK premtoi se ne muajin Shtator do te hapin kursin e Gjuhes Shqipe ne kuader te Bashkise Sakarya- Adapazar dhe do te kemi nje bashkepunim te ngushte me Qendren Kulturore te Kosoves ne Stamboll e cila ka nje pervoj ne kete drejtim.

Z. Qamil BYTYÇI premtoi se si Qender Kulturore e Kosoves do ta perkrahim Bashkine Sakarya – Adapazar ne gjetjen e mesimdhenesit per kursin e Gjuhes Shqipe si dhe per literaturen e nevojshem ne kete drejtim.

Ne fund nga U.D. Drejtori i Qendres Kulturore te Kosoves z. Qamil BYTYÇI drejtorit te Drejtorise se Kultures dhe Puneve Shoqerore te Bashkise Sakarya - Adapazar Z. İbrahim AKTÜRK iu dhurua libri “ **majestic KOSOVA madheshtore** “ i botuar nga Ministria e Diaspores se Republikes se Kosoves.

Z. İbrahim AKTÜRK iu dha lista e 83 shqiptareve me banim ne Sakarya – Adapazar qe kane shprehur deshiren per pjesmarrje ne kursin e Gjuhes Shqipe.





